



# ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

*Gjithcka që duhet ta keni!*

**KOMPANIA E SIGURIMEVE “Elsig” SH.A. - PRISHTINË**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME  
PËR SIGURIMIN KASKO TË MJETEVE MOTORIKE**

**Prishtinë, shkurt 2012**

**Në bazë të nenit ... pika ... të Statutit të Kompanisë së sigurimeve “Grawe Elsig “ sh. a. Bordi Drejtues i Kompanisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 2012. miratoi Plotesimin dhe ndryshimin e Kushteve të Përgjithshme për sigurimin “kasko” të mjeteve motorike.**

Vrejtje: Teksti me ngjyre te kuqe eshte tekst i korrigjuar dhe duhet te miratohet nga Bordi Drejtues.

## **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË MJETEVE MOTORIK (KASKO E PLOTE DHE KASKO E PJESËSHME**

### **Terma të përgjithshëm:**

“**Siguruesi**” është Kompania e Sgurimeve “Grawe ELSIG”, e cila lëshon policën e sigurimit dhe garanton se në rast të një ngjarje, dëmi do ta zhdëmtojë të “siguruarin”.

“**I Siguruari**” është personi fizik ose juridik, i cili pas nënshkrimit të kontratës – policës së sigurimit – do të quhet edhe police-mbajtësinteresi dhe interesi i sigurimit të tij është mbrojtja financiare në rast të një dëmi në mjetin e tij motorik për të cilin do të kompenzohet nga “siguruesi”.

“**Përfaqësuesi**” do të thotë personi fizik ose juridik, i cili në emër dhe në interes të siguarit ngarkohet me lidhjen dhe nënshkrimin e kontratës së sigurimit.

“**Mjet motorik**” do të thotë një mjet lëvizës me anë të energjisë së vetë. Mjete motorike do të quhen edhe rimorkiot ose gjysëm rimorkiot, pavarësisht nëse janë të bashkuara apo jo me mjetin motorik tërheqës.

“**Përdoruesit - shfrytzuari**” kupton personat që përdorin mjetin motorik të siguruar, emrat e të cilëve shënohen detyrimisht në formën propozuese dhe/ose edhe në kontratën e sigurimit dhe për të cilët është i vlefshëm mbulimi në rast sigurimit.

“**Polica e Sigurimit**” është Kontrate e lidhur midis Siguruesit dhe të Siguarit për marreveshtjen e arritur për sigurim.

“**Franshiza**”- Pjesa e zbritshme, gjegjesisht pjesëmarrja në dem nga I Siguruari, e cila mund të jete në \_\_\_% dhe \_\_\_\_\_€, vlerë absolute.

### **PERIUDHA E SIGURIMIT**

Polica e Sigurimit mbulon dhe vlen vetëm për dëmet që ndodhin gjatë periudhës kohore të sigurimit të treguar në Policën valide të Sigurimit. Periudha e sigurimit si rregull është një veçare, përveç rasteve kur në Policën e sigurimit përcaktohet ndryshe.

Mbulesa Siguruese është valide me pagesen e primit të Sigurimit dhe e kundërta nuk ka mbulesë siguruese pa u paguar primi i sigurimit.

### **SHTRIRJA TERRITORIALE**

Polica e Sigurimit vlen për dëmet që ndodhin në territorin e Kosovës dhe jashtë tij, siç është cekur në te. Zgjerimi i mbulimit të teritorit jashtë territorit të Kosovës mund të bëhet kundrejtë pagesës së primit shtesë.

### **OBJEKTI I SIGURIMIT**

Siguruesi ofron mbulim për të gjitha mjetet motorike rrugore, binarike, mjete motorike të punës dhe të tjera., lidhur me humbjen apo dëmtimin e plotë apo të pjesëshëm të tyre si rezultat i rreziqeve të mbuluara - parashikuara në këto kushte sigurimi, të shkruara në policën e sigurimit. Siguruesi do të mbulojë të gjitha dëmet kur mjeti motorik i siguruar

është në lëvizje, ose në vendparkim.

## **KASKO E PLOTË**

**Polica Kasko e Plotë do të mbulojë humbjet ose dëmet e shkaktuara nga rreziket e siguruar te cekura ne policë :**

### **Aksidenti në trafik(gjatë lëvizjes), përplasia, përmbysja, rrëshqitja.**

Dëmtimi aksidental, përplasia dhe/ose përmbysja e mjetit tuaj motorik edhe kur jeni vetë-fajtorë për aksidentin, duke përfshirë drejtimin e automjetit pa patent shofer, pa aftësi për drejtim të mjetit motorik (p.sh. alkool, mjete tjera narkotike ose mbilodhje, si dhe dëmtime të natyrës teknike (p.sh. dëme në motor, frenat, kabllot elektrike, konsumimi(amortizimi) i tepërt etj)

### **Dëmet në vendparkim;**

Dëmtimi i mjetit tuaj motorik të parkuar, në vende të parapara nga organet kompetente, nga një mjet tjetër motorik të përdoruesit si dhe dëmet qëllimkëqia nga persona të panjohur, duke përfshirë dëmet që janë të lidhura ngushtë me ngjarje të luftës, demonstrata dhe rrebelim civil.

### **Përplasia me shtazë të egra;**

Përplasia me shtazë të egra dhe ato shtëpiake si dhe dëmet në kabllim nga parazitë të ndryshëm..

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet në mjetin tuaj motorik shkaktuar nga:

### **Dëmet nga katastrofa natyrore:**

**Zjarri, eksplozioni dhe rrufeja;Stuhia, breshëri, përmbytja,dëborë,orteku, rrëshqitja e bores dhe akullit nga kulmi,** kur katastrofa natyrore është e njohur nga autoritetet përkatëse shtetërore.

Siguruesi do të paguajë gjithashtu edhe dëmet e shkaktuara në mjetin tuaj motorik nga rënja e objekteve të ndryshme, që ndodhin si pasojë e katastrofave natyrore. Siguruesi do të jetë gjithashtu përgjegjës për dëmet në mjetin tuaj motorik të shkaktuara nga përmbytja e garazhit si rezultat i çarjes së tubacioneve të ujrave edhe në rast se nuk ka ndodhur katastrofë natyrore, duke përfshirë dëmet nga derdhja e ujit prej rubineteve të hapura, pëlcitja apo çarja e gypave të vjetër ose të koroduar, nga bllokimi e kanalizimit nga çfarëdo hedhurine, tërmeti dhe rrëshqitja e tokës si dhe dëmet gjatë kalimit të lumenjëve ose pellgjeve.

### **Ramja e objekteve - fluturakeve ajrore dhe pjesëve të tyre;**

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet si pasojë e ramjes së drejtpërdrejtë të një fluturake ajrore si dhe pjesëve të sajë në mjetin motorik të siguruar.

### **Vjedhja e plotë apo e pjesëshme;**

**Vjedhja:** do të konsiderohet veprimi i përvetësimit në mënyrë të fshehtë, nga një ose më shumë persona, i mjetit motorik të siguruar (vjedhja totale) ose i pjesëve apo pajisjeve të tij (vjedhje e pjesëshme),

**Tentim vjedhje:** do të konsiderohet çdo veprim që ka synuar vjedhjen e mjetit motorik të siguruar ose pjesëve të tij , por që nuk ka arritur të kryhet veprimi, duke shkaktuar dëme ndaj mjetit motorik.

### **Perjashtohen dëmet nga vjedhja dhe tentim vjedhje:**

- a. Dëmet nga vjedhja, nëse ato janë kryer nga i Siguruar dhe anëtarët e familjes ose përdoruesit, nga punonjësit e shërbimit, ruajtjes apo të mbikqyrjes të vendit të punës apo parkimit;
- b. Dëmet nga vjedhja ose tentim vjedhje kur nuk janë mbyllur mirë dyert, tavani i lëvizshëm, xhamat ose qelësat e mbylljes janë lënë brenda mjetit, mbi ose përreth tij;
- c. Dëmet nga vjedhja e pjesëshme me shkaqe të pashpjegueshme pa shenja e gjurmë të dukshme.
- d. Vjedhja e pajisjeve të tilla si autoradio, antenna, atuparlante, përveç vjedhjes totale të mjetit motorik të siguruar.

### **Thyerjen e xhamave:**

Thyerje e xhamave do të kuptohet që nga plasaritja deri tek thërmimi i xhamave të përparëm, të pasëm, anësor, të tavaneve të lëvizshëm të shkaktuar nga goditja e një objekti të lëvizshëm, por duke përfshirë: dëmet në çdo xham tjetër që nuk përfshihet në katalogun e prodhimit, por që është vendosur në mjetin motorik, gjatë qëndrimit në parking të Automjetit të siguruar, njëheri ndodhia duhet të lajmërohet dhe të dëshmohet nga Organi i hetusise, shpk.

Polica Kasko e pjesëshme do të mbulojë humbjet ose dëmet e shkaktuara drejtpërdrejtë nga:

**I. Zjarri , rrufeja dhe eksplozimi:** që vijnë nga faktorë të jashëtm, të papritur dhe përfshijnë mjetin e siguruar, duke përjashtuar:

- a. Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo eksplozioni, që vijnë nga shkaqe të brendshme të mjetit motorik;
- b. Dëmet e shkaktuara nga zjarri apo eksplozioni ku shkak ka qenë pirja e duhanit në mjetin motorik;
- c. Dëmet kur aksidenti nuk është njoftuar në polici apo në repartin zjarrëfikës.

## **II. Vjedhja dhe tentim vjedhja**

**Vjedhja dhe tentim vjedhja :** do të konsiderohet veprimi i përvetësimit në mënyrë të fshehtë, nga një ose më shumë persona, i mjetit motorik të siguruar (vjedhja totale) ose i pjesëve apo pajisjeve të tij (vjedhje e pjesëshme), gjate qendrimit ne hapsira te mbyllur ne garazhe, per kohe qe nuk eshte ne shfrytezim.

### **Perjashtohen dëmet nga vjedhja dhe tentim vjedhje:**

- e. Dëmet nga vjedhja, nëse ato janë kryer nga i Siguruari dhe anëtarët e familjes ose përdoruesit, nga punonjësit e shërbimit, ruajtjes apo të mbikqyrjes të vendit të punës apo parkimit;
- f. Dëmet nga vjedhja ose tentim vjedhje kur nuk janë mbyllur mirë dyert, tavani i lëvizshëm, xhamat ose qelësat e mbylljes janë lënë brenda mjetit, mbi ose përreth tij;
- g. Dëmet nga vjedhja e pjesëshme me shkaqe të pashpjegueshme pa shenja e gjurmë të dukshme.
- h. Vjedhja e pajisjeve të tilla si autoradio, antenna, atuparlante, përveç vjedhjes totale të mjetit motorik të siguruar.

## **PËRJASHTIMET E PËRGJITHSHME**

- a) Dëmet e shkaktuara qëllimisht dhe/ose të udhëzuara nga personi i siguruar;
- b) Dëmet që rezultojnë nga çdo akt i luftës, invazionit, veprimeve të tjera të armatosura pavarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo. Lufta civile, turbullira civile, revolucione, lëvizja separatiste, kryengritja popullore, rebelimit, revolta, puce, grushte shteti, eksode, akteve terroriste, trazirave, grevës, sabotimit.
- c) Dëmet që vijnë si rezultat i shpërthimit bërthamor, rrezatimit bërthamor, ndotjes radioactive, rrezatimeve jonizuese, ndotjeve kimike etj.
- d) Dëmet në mjetin motorik të siguruar, të konfiskuar ose në tentativa konfiskimi nga Organet e Shtetit,
- e) Dëmet që shkaktohen nga përdorues, emrat e të cilëve nuk janë shënuar në kontratën e sigurimit;
  
- f) Dëmet që rezultojnë nga amortizimi i tepërt, defektet apo avaritë e brendshme elektrike apo mekanike gjatë ndezjes ose lëvizjes së mjetit;
- g) Prerja, shpuarja dhe dëmtimi i gomave në rrugë si dhe shkëputja e tyre nga mjeti motorik,
- h) Dëmet në mjetin e siguruar motorik në Operacione si: shërbimi, riparimi, kontrolli, larja, parkimi, dorëzimi ose shitja;
- i) Dëmet e shkaktuara nga përdoruesit, pa patent shoferi;
- j) Dëmet e shkaktuara kur drejtuesi i mjetit ndodhet nën ndikimin e efekteve të alkoolit dhe drogës ose refuzon ti nënshtrohet provave të këtij kontrolli;
- k) Dëmet e shkaktuara në mjet nga transportimi i lëndëve radioaktive, eksplozive, gërryese, ndezëse, jonizuese etj. Siguruesi do të paguajë këto dëme nëse është rënë dakort më parë duke paguar një prim shtesë;
- l) Dëmet ose humbjet e objekteve, sendeve personale, mallrave ose bagazheve që ndodhen në mjet në momentin e rastit të sigurimit;
- m) Siguruesi nuk do të mbulojë zmadhimin e humbjeve ose dëmeve për shkak të neglizhencës së të siguruarit ose mosmarrjes së masave parandaluese që të mos thellohen ato. Siguruesi do të paguajë shpenzimet e arsyeshme të bëra që nuk lejojnë që të zmadhohen dëmet ose humbjet;

## **KONTRATA E SIGURIMIT**

### **1. Kontrata për sigurim**

Kupton kërkesën e të siguruarit për sigurimin e mjetit të tij motorik duke i dhënë përgjigje formës propozuese standarde (Kërkesa për sigurim Kasko) të përgaditur nga Siguruesi. I siguruari ose personi i atuarizuar nga ai, nënshkruan së bashku me agjentin ose personelin e marrjes në sigurim kërkesën për sigurim dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e deklarimeve të bëra në të.

Pas plotësimit të Kërkeses për sigurim, i siguruari nuk mund të kryejë ose lejojë ndryshime që sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin me shkrim të siguruesit. Me shtim të rrezikut kuptohen rrethanat që janë thelbësore të cilat mund të influencojnë vendimin e siguruesit për të lidhur ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë. Në rast të moszbatimit të kushtit të mësipërm, Siguruesi lirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit:

### **2. Lidhja e kontratës**

Kontrata e sigurimit hyn në fuqi në datën e lëshimit të saj, pas orës 24, me kusht që të jetë paguar më parë primi i sigurimit. Kur sigurimi përsëritet pa ndërprerje, detyrimet e siguruesit fillojnë menjëherë pas përfundimit të periudhës së mëparshme të sigurimit. Kontrata mbetet në fuqi me të njëjtat kushte edhe për 15 ditë gjatë sëcilës i siguruaru duhet të paguajë primin e sigurimit (grace periode). Pas këtij afati, nëse nuk është paguar primi i sigurimit, atëherë nuk ka mbulesë siguruse, njëheri siguruesi nuk mban përgjegjësi dhe nuk ka obligim të paguaj për dëmet e ndodhura, si pasojë e mos pageses së primit.

Për rastet e sigurimeve kur Polica e sigurimit Kasko, ipet që pagesa e primit të sigurimit të paguhet me kiste dhe gjatë periudhës së mbulesës siguruese ndodhin dëme të mbuluara me rreziqe të siguruaras të theksuara në police të sigurimit, në ato raste dosja e lëndës trajtohet dhe finalizohet për pagesë, I Siguruari uredhnohet që të beje pagesën e plote të primit të sigurimit të papaguar (fjala është për vlerën e gjithëmbarshme të kisteve) dhe pasi të deshmohet se është paguar primi, behet pagesa e lartësise së demit.

### **3. Natyra dhe shtrirja**

Kontrata e sigurimit përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, natyrën dhe shtrirjen e mbulimeve si dhe ndryshimet e primeve që rezultojnë nga ndryshimi i faktorëve të rrezikut. Ajo nënshkruhet nga të dy palët, siguruesi dhe i siguruari ose personat e atuarizuar prej tyre dhe lëshohet pas pagesës së primit të sigurimit, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe.

#### 4. Kalimi i drejtave

Të drejtat dhe detyrat e të siguruarit në këtë kontratë nuk mund të kalojnë tek një person tjetër pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Ky miratim do të shoqërohet me ndryshimet përkatëse në kontratën e sigurimit. Në rast se i siguruari vdes, mbulimi për mjetin e siguruar do të vazhdojë të zbatohet për trashëgimtarët ligjorë ose përfaqësuesin zyrtarë tek të cilët kalojnë të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë për përdorimin e mjetit motorik, deri në fund të periudhës së sigurimit.

Kur I Siguruari bene shitjen e automjetit te siguar Kasko dhe periudha e sigurimit nuk ka perfundua, atehere nese shitesi i jep policen e sigurimit blesit, polica e sigurimit nuk kthehet, por vetem korigjohet me te dhenat e pronarit te ri (blesit).

Kur I Siguruari bene shitjen e automjetit te siguar Kasko dhe periudha e sigurimit nuk ka perfundua,dhe kerkon kthimin e primit te paskaduar, atehere polica e sigurimit mund te kthehet, por verifikohet se ne periudhen e kaluar te sigurimit nuk ka patur dem te paguar apo te rezervuar qe eshte shkaktuar nga rreziqet e mbuluara me police valide kasko,ne te kunderten nuk lejohet te behet kthimi i primit.

#### 5. Kontrata e Sigurimit shkëputet - ndërpritet në këto raste:

Kontrata mund të shkëputet apo të ndërpritet pas njoftimit me shkrim të secilës pale që e dëshiron këtë duke përcaktuar datën e shkëputjes së saj.

##### **Siguruesi do të shkëputë – ndërprej kontratën e sigurimit nëqoftëse:**

- Nuk është paguar primi i sigurimit, ose primi i sigurimit për kontratat e ripërtitura. Data e shkëputjes do të jetë 15 ditë pas mbarimit të afatit të pagimit.
- Duke njoftuar 30 ditë përpara datën e shkëputjes,
- Kur atij ose përdoruesit të mjetit motorik iu është marrë patent shoferi gjatë muajve të fundit,
- Me skadimin e afatit të kontratës së sigurimit,
- Shkatërrimin e automjetit (dëmi total),
- Me pagimin e kompensimit të dëmeve, me realizimin e rrezikut të vjedhjes së automjetit,
- Me pagimin e kompensimit të dëmit në lartësinë e shumës së kontraktuar të sigurimit për një rast dëmi,
- Me përmbushjen e lartësisë së shumës së sigurimit të shënuar në police të sigurimit, për disa raste të sigurimit në periudhën e njëjtë të sigurimit (shuma e të gjitha dëmeve deri në shumën e sigurimit).
- Kur riparimi i automjetit ekonomikisht nuk është i arsyeshëm (dëmi total ekonomik) shitjen e automjetit,

Në qoftë se Siguruesi i ofron të Siguararit ose personit të autorizuar ripërtitjen e kontratës dhe këta të fundit nuk e pranojnë, kontrata do të përfundojë automatikisht në fund të periudhës së sigurimit.

Kthimi i primit kur shkëputja ndodh nga Siguruesi apo i Siguruari do të jetë proporcional me pjesën e mbetur të periudhës së sigurimit, pasi të jen zbritur shpenzimet administrative në masën prej 10% të primit të shkruar bruto.

#### **SHUMA E SIGURUAR**

Çdo mjet motorik sigurohet për tu mbuluar nga rreziqet deri në një vlerë që përcaktohet ndërmjet palëve, kundrejt së cilës llogaritet edhe primi i sigurimit dhe quhet **shuma e siguruar**.

- Për mjetet e reja:

**Shuma e siguruar** është vlera e blerjes së mjetit të ri sipas faturës së furnitorit, duke i shtuar edhe transportin, doganën dhe tatimin.

- Për mjetet e përdorura:

**Shuma e siguruar** është vlera e mjetit motorik në treg në momentin e marrjes në sigurim duke u bazuar në çmimet e referencës sipas „katalogjeve ndërkombëtare“.

**Shuma e siguruar vendoset në kontratën e sigurimit (policë)**

#### **PJESA E ZBRITSHME DHE FRANSHIZA**

Në rast të dëmit do të zbatohet pjesa e zbritshme dhe/ose franshiza. Për çdo rast dëmi siguruesi do të zbrësë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme dhe/ose franshizën të përcaktuar në kontratën e sigurimit në shumë absolute ose në përqindje.

Pjesa e zbritshme munde te jete:

P.sh.

- **Shuma e sigurimit: 30,000.00€**
- **Dëmi: 10,000.00€.**
- **Pjesa e zbritshme ne (%): 10% nga vlera e përgjithshme e dëmit, ne kete rast eshte 1,000€.**



Siguruesi do të paguajë: **9,000.00€**.

Psh.

- **Shuma e sigurimit: 30,000.00€.**
- **Franshiza e zbritshme ne vlere absolute, psh 5,000.00€.**
- **Dëmi: 10,000.00€.**

Pjesa e zbritshme ne vlere absolute 5,000.00€.

Kompensimi i demit **është: 10,000.00 €**

**Vrejtje:** Ne kete rast qdo dem i ndodhur deri ne vlere 5,000.00€ nuk do te paguhet.

Siguruesi do te paguaj qdo dem mbi vlerë 5,001.00€.

## **TARIFA E PRIMIT TË SIGURIMIT**

Tarifa e primit të sigurimit përcaktohet në bazë të llogaritjeve sipas mbulimit të zgjedhur, klasifikimit dhe veçorive të mjetit motorik dhe vendoset në kontratën e siurimit.

## **PRIMI I SIGURIMIT**

I siguruari është i detyruar t'i paguajë siguruesit primin e sigurimit sipas shumës dhe afateve të përcaktuara në kontratë. Pagesa e primit bëhet pranë Filialit ku është lëshuar kontrata e sigurimit, por gjithmonë përmes transferit bankar dhe jo në të gatshme (cash).

### **Ngritja e primit të sigurimit:**

- a) nëse pronari-shfrytëzuesi ka shkaktuar dëm në periudhën praprake të sigurimit (përveç nëse dëmi është shkaktuar gjatë transportimit-shpëtimit të të aksidentuarve), për **15%**
- b) nëse pronari-shfrytëzuesi ka moshën 18 – 24 vjeçe, për **10%**
- c) **Ngritje e primit per Taxi 50% dhe Renta Car 100%**
- d) Ngritje e primit për sigurime jashtë Kosovës **50%**.

### **Zbritja e primit të sigurimit:**

- 1) Për të siguruarin, i cilin në afatin praraprak 1 vjeçar nuk ka shkatuar dëm, për 10%;
- 2) Për të siguarit që në KS „Grawe Elsig“ sigurojnë 5 e më shumë mjete motorike, për 10%;
- 3) Për të siguarit, cilët e kanë edhe policën e autopërgjegjësise (TPL) në KS „Grawe Elsig“, për 15%;
- 4) Zbritje per anetare te shoqatave te Invalideve te dalur nga Lufta ne Kosove 5%;
- 5) Zbritje per shofer profesionist 5%;
- 6) Zbritje per ndermarrjet publike 5%
- 7) Zbritje e primit për 3% , kur primi i sigurimit bëhet me rastin e lëshimit të polices(kesh, pagesa në bankë) dhe
- 8) Maksimumi i lejuar i zbritjeve të primit është : 50% nga primi bazë vjetor

## **SIGURIMET TJERA**

- Në se i siguruari kontrakton edhe sigurim tjetër të mjetit të tij motorik, tek Kompani Sigurimi tjetër, ai duhet të njoftojë menjëherë me shkrim siguruesit, emrin e siguruesit tjetër dhe shumën e siguarar. Kur i siguruari me dashje ose për shkak të pakujdesisë nuk plotëson detyrimet e mësipërme, atëherë siguruesi ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës së sigurimit dhe mospagimit të dëmshpërblimit.
- Nëse në momentin e ndodhjes së një dëmi, sipas kësaj kontrate ekzistojnë sigurime të tjera, të cilat mbulojnë të njëjtin rrezik, masa e dëmshpërblimit që përfiton i siguruari nga të gjitha kontratat e sigurimit nuk mund të jetë më e larët se sa masa e dëmit minus pjesën e zbritshëm. Pjesa e dëmit që paguajnë siguruesit është proporcionale me shumën e sigurimit
- Nëse i siguruari kontrakton edhe sigurime të tjera me qëllim të përfitimit të paligjshëm, kontrata e sigurimit do të quhet e pavlefshme dhe siguruesi mban primin e sigurimit.

## **MBISIGURIMI**

- Nëse shuma e siguarar e tejkalon ndjeshëm vlerën e mjetit motorik, atëherë si siguruesi ashtu edhe i siguruari mund të kërkojnë zvogëlimin e shumës së siguarar dhe primi i sigurimit do të pakësohet përkatësisht.
- Nëse i siguruari lidh kontratën e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime nga mbi-sigurimi, kontrata do të quhet e pavlefshme. Siguruesi ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit.

## **NËNSIGURIMI**

- Nëse në momentin menjëherë pas ndodhjes së rastit të sigurimit shuma e siguruar është më e ulët se vlera e mjetit motorik, dëmshpërblimi i llogaritur do të shumëzohet me koeficientin e nën-sigurimit, i cili përcaktohet si raport i shumës së siguruar ndaj vlerës së mjetit.

## **NJOFTIMI I RASTIT TË DËMIT**

I siguruari ose përfaqësuesi ligjor i tij, që kërkon të dëmshpërblehet për dëmet në mjetin e tij motorik, janë të detyruar që menjëherë të njoftojnë rastin e siguruar. Rasti i siguruar kupton ndodhinë gjatë së cilës mjeti motorik përfshihet në një aksident ose vjedhje.

- Njoftimi i rastit të siguruar duhet të bëhet brenda 48 orëve nga momenti i ndodhjes së aksidentit pranë degës, në territorin e së cilës ndodhet agjencia që ka lëshuar kontratën e sigurimit ose pranë degës më të afërt.
- Në rastin e vjedhjes, lajmërimi dhe denoncimi pranë Organeve të Rendit Publik duhet të bëhet brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes.
- Në rastin e zjarrit, eksplozionit dhe rrufesë, lajmërimi pranë zjarrfikësve më të afërt nga vendi i ngjarjes duhet të jetë i menjëhershëm ose brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes së rastit.
- Në rastin e thyerjes së xhamit lajmërimi duhet të bëhet brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes apo konstatimit të rastit, pranë degës së "Grawe Elsig", në territorin e së cilës ndodhe agjencia që ka lëshuar kontratën e sigurimit.
- Kopja që dëshmon për lajmërimin dhe denoncimin pranë këtyre organeve, i vihet në dispozicion siguruesit së bashku me njoftimin e rastit, jo më vonë se 48 orë nga momenti i ndodhjes.
- Formulari standard i njoftimit të rastit të siguruar, i përgatitur nga siguruesi duhet të plotësohet me besnikëri dhe në afatet e mësipërme, pa shtrembërime të fakteve. Në rast të kundërt, siguruesi ka të drejtë të lirohet nga detyrimet për pagesën e dëmit.

**Për të gjitha njoftimet, kërkesat dhe informata plotësuese ju ndihmon Qendra jonë për Përkujdesje të Klientëve nën numrin e telefonit falas: 038 / 221 112**

## **VLERSIMI I DËMIT**

I siguruari për dëmet në mjetin e siguruar paraqet kërkesën për dëmshpërblim brenda afateve të parashikuara nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrueshme, vetëm pasi ka bërë njoftimin e rastit nëpërmjet formularit standard.

- Siguruesi ka të drejtë të verifikojë vërtetësinë e rastit të siguruar si dhe të madhësisë së dëmit, brenda 10 ditëve nga momenti i njoftimit të rastit. Derisa siguruesi të përfundojë me hetimet e nevojshme, mjeti motorik do të mbahet i riparuar nga i siguruari.
- Kërkesa për dëmshpërblim i drejtohet degës në territorin e së cilës ndodhet agjencia që ka lidhur kontratën. I siguruari është i detyruar të paraqesë kur i kërkohe të gjitha dokumentet e nevojshme që kanë lidhje me rastin e siguruar.
- Vlerësimi i dëmit duhet të jetë brenda limiteve të përgjegjësisë.
- Në rast mosmarrëveshjeje, por vetëm pasi siguruesi ka ofruar vlerësimin e tij, të dy palët thirrin një komision arbitrazhi të paanshëm, me pjesëmarrjen e ekspertëve të secilës palë dhe të një eksperti të tretë të paanshëm. Shpenzimet e këtij komisioni përcaktohen në momentin e themelimit të tij nga palët.

## **LIMITET E PËRGJEGJËSISË**

Limiti i përgjegjësisë për dëmet në mjetin e siguruar është:

- a) Vlera e nevojshme për riparimin e mjetit të dëmtuar ose shumën në të gatshme (cash) për të zëvendësuar dëmin sipas vlerës së tregut në Kosovë në momentin e ndodhjes së dëmit.
- b) Vlera e mjetit të vjedhur ose dëmtuar sipas vlerës së tregut në Kosovë në momentin e ndodhjes së dëmit, por jo më shumë se shuma e siguruar.

Pjesët që mbeten të padëmtuara do të zbriten nga vlera aktuale. Vlerësimi i këtyre pjesëve është i ngjashëm me vlerësimin e dëmit. Siguruesi nuk është i detyruar të mbajë vlerën e pjesëve të mbetura të padëmtuara, përveç rasteve kur bihet dakord midis palëve.

## **PAGESA E DËMIT**

Siguruesi do të paguajë të siguruarin ose trashëgimtarin ligjor të tij për dëmet në mjetin motorik të siguruar deri në limitin e përgjegjësisë duke zbritur mbetjen dhe pjesën e zbritshëm të përcaktuar në kontratën e sigurimit. Dëmet me vlerë më të vogël se franshiza ose pjesa e zbritshëm e përcaktuar në kontratën e sigurimit nuk do të paguhet.

- a) Siguruesi do të paguajë dëmin brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për dëmshpërblim dhe pas dorëzimit të dokumenteve të nevojshme të kërkuara prej tij.

- b) Në qoftë se mjete motorik është përfshirë në një rast sigurimit të vjedhjes, siguruari pas 30 ditëve duhet të parapaguajë një pjesë të dëmshpërblimit deri në 50% të limitit të përgjegjësisë.
- c) I siguruari do të njoftojë brenda 5 ditëve nga ndodhja rastit të siguarit në qoftë se mjete i vjedhur do të gjendet. Në rast se nuk është bërë parapagimi, mjete motorik i gjetur do të vihet në dispozicion të siguarit, ndërsa siguruari paguan dëmet që mund të rezultojnë dhe që janë të mbuluara në sigurim. Në rast se është bërë parapagimi nga siguruari, mjete motorik i gjetur duhet të vihet në dispozicion të tij, ndërsa të siguarit do të paguhet pjesa e papaguar deri në limitin e përgjegjësisë. I siguruari ka të drejtë të marrë mjetin duke kthyer parapagimin e bërë nga siguruari duke reduktuar nga kjo pagesat për dëmet që mund të rezultojnë.
- d) Pjesa e papaguar deri në limitin e përgjegjësisë duke zbritur pjesën e zbritshëm duhet paguar kur të gjitha procedurat hetuese janë mbyllur, por jo më shumë se 180 ditë.
- e) Në rast se është bërë dëmshpërblimi deri në limitin e përgjegjësisë dhe mjete gjendet, ai do të vihet në dispozicion të siguarit. I siguruari ka të drejtë të marrë mjetin duke kthyer pagesën që i është bërë.
- f) Në rast se i siguruari nuk është dakord me dëmshpërblimin e ofruar, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit nga siguruari, duhet të paraqesë refuzimin me shkrim.
- g) Në rast se i siguruari ka bërë deklaratë të rreme, është implikuar në veprime mashtrimi duke përvetësuar me të padrejtë një dëmshpërblim, siguruari ka të gjitha të drejtat e personit të dëmtuar kundër tij.
- h) Siguruari do të paguajë deri në 30.00€ për person dhe deri në 300.00€ gjithsej për shpenzimet e transportit e të ngarkim-shkarkimit nga vendi i ndodhjes së rastit të sigurimit (për mjetin motorik që nuk lëviz) deri në vendmbërritje, pa u përsëritur kjo rrugë.
- i) Siguruari paguan edhe shpenzimet e ruajtjes nga momenti i rastit të sigurimit deri në përfundim të ekspertizës së nevojshme, por jo më shumë se 20€ gjithsej.

#### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Kur mosmarrëveshjet midis të siguarit dhe siguarit nuk zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen nga Gjykata e vendit ku është lidhur kontrata e sigurimit.

Këto Kushte hyjnë në fuqi ditën e miratimit dhe do të zbatohen prej **shkurt 2012**.

Drejtori i Përgjithshëm

Rexhep Idrizaj

\_\_\_\_\_